



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRIKUM ZA OKOLNU, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr./No. Org. Org./Jedinita Org./Unit	ARPL
Nr./I Faqes Re Stranica No Pages	04
Nr./I Prot. Prot. No.	5715-2/35
Data Datum	07.08.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry Of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Opsteg Sekretara/Office of the General Secretary

DATË/A:	04.08.2025
REFERENC-Ë:	5715/25
PËR/ZA/TO:	NI & BE INVEST L.L.C. Adresa: Çeta e Llapit, 61, Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së Z. Fatos QERIMI, Drejtor i ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Fidan BILALLI, U.D. Udhëheqës i Divizionit të Akteve dhe Financa Ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - PËLQIM UJOR

Të nderuar,

Bazuar në kërkesën me nr. të protokollit 5715/25 të datës 29.07.2025, nga pala NI & BE INVEST L.L.C. me nr. të certifikatës së biznesit 812160563, me seli në Prishtinë, për çasje në rrugë – kalim mbi pronë ujore, Autoriteti i Rajonal i Pellgjeve Lumore ka vendosur si në Vendim për Pëlqim Ujor, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry Of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Opsteg Sekretara/Office of the General Secretary

Nr. P.U.

Datë 04.08.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 26, paragrafi 3, si dhe nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

PËLQIM UJOR

APROVOHET kërkesa e palës: **NI & BE INVEST L.L.C.**, për Pëlqim Ujor me nr. të prot. 5715/25 të datë 29.07.2025, për çasje në rrugë – kalim mbi pronën ujore, e identifikuar njësia kadastrale nr. 2545-0 në Z.K. Podujevë, K. Podujevë.

Pëlqimi Ujor jepet me kushtet si në vijim:

1. Pëlqimi Ujor lëshohet në bazë të Studimit Hidrologjik për kalim të lirë mbi pronën ujore për njësin kadastrale të cekur më lart, e cila identifikohet P.SH.Ujërat, nga prona private e palës me nr. të ngastresë P-71712062-03246-0, Zonë Kadastrale Podujevë, K. Podujevë, në bazë të dokumentacionit tekniko-investiv, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe si i tillë të ruhet nga pala;
2. Bazuar në Nenin 5, respektivisht paragrafit 3 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2016 për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore, ku për të gjitha ujërrjedhat, brezi breg-ujor është 5 metra nga shtrati i rrjedhjes, sipas llogarive hidraulike për periudhën kthyesë të plotave (ujërave maksimale) $P=50$ vite dhe $P=100$ vite;
3. Ndërtimi i objekteve banesore duhet të bëhet në bazë të projektit kryesor në harmoni me Ligjin e Ndërtimit;
4. Përgjegjësia për dëmet e mundshme që mund të shkaktohen nga vërshimet do të bije mbi palën, pa të drejtën e kompenzimit;



5. Kalimi mbi pronën ujore, bëhet vetëm brenda pjesës, respektivisht me sipërfaqe deri në 48.0 m² në vendin e paraparë sipas situacion gjeodezik, pra brenda koordinatave:

Nr.	X	Y
1	7515872.123	4750779.734
2	7515874.572	4750779.398
3	7515876.083	4750779.340
4	7515878.766	4750779.521
5	7515878.766	4750777.506
6	7515878.716	4750776.843
7	7515879.552	4750774.586
8	7515880.614	4750771.715
9	7515881.026	4750770.603
10	7515881.442	4750769.829
11	7515879.730	4750769.568
12	7515877.602	4750769.385
13	7515875.553	4750769.351
14	7515874.888	4750771.371
15	7515873.877	4750774.441
16	7515872.842	4750777.586

6. Pala duhet të ketë parasysh se, kalimi i lirë nuk do të thotë se prona shoqërore e ujërave mund të kalojë në pronësi të palës, si dhe përveç kalimit nuk duhet të ketë destinim tjetër, pra duhet të ruaj funksionalitetin aktual duke mos ndërtuar infrastrukturë, përveç se asaj të kalimit etj;
7. Në pjesën tjetër të pronës ujore, nuk lejohet ndërtim, apo çfarë do aktiviteti tjetër të paraparë, që nënkupton shfrytëzim;
8. Ky Pëlqim Ujor vlen vetëm për kalim mbi pronën ujore, ndërsa për kycje në rrugën publike, duhet të sigurojë pëlqim nga organi kompetent për infrastrukturë rrugore;
9. Pala duhet të ketë parasysh, se me rastin e hartimit të Planit të Menaxhimit të Resurseve Ujore, nëse parashihet ndryshe për kushte tjera, ndryshe nga rasti në fjalë, duhet t'i adaptohet atyre, sipas kërkesave të nevojshme, pa ndonjë kompensim;
10. Vlefshmëria i Pëlqimit Ujor është dy vite (2) nga data e lëshimit të tij, nëse deri në këtë datë nuk është siguruar leja ndërtimore dhe fillimi i punimeve.

Arsyetim

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 03/2018 për Procedurën për Leje Ujore, Udhëzimin Administrativ nr. 05/2016 për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim për Pëlqim Ujor, ku në afërsi të pronës ujore do të ketë ndërtim të objekteve banesore.

Pala, NI & BE INVEST L.L.C., ka bërë kërkesë me nr. Prot. 5715/25 me datë 29.07.2025, për çasje në rrugë me mundësinë e kalimit mbi Pronën Ujore, sipas njësisë kadastrale nr. 2545-0 në Z.K. Podujevë, K. Podujevë nga prona private me nr. P-71914075-01681-0, Zonë Kadastrale Podujevë. Andaj ky vendim për pëlqim ujor është nxjerrur mbi bazën e dokumentacionit tekniko-investiv dhe verifikimit të pronës ujore nga Agjensionin Kadastral të Kosovës.

Kërkesës, pala i ka bashkangjitur:

- Aplikacionin për Pëlqim Ujor;
- Faturën e pagesës (taksës) me rastin e aplikimit nr. 000406,
- Autorizimin e Përgjithshëm nga Noteri për përfaqësim të pronarëve;
- Çrtifikatën e Biznesit të lëshuar nga ARBK me NUI 812160563;
- ID lejenjoftimi me nr. 2030719037;
- Elaboratin Hidrologjik;
- Autorizimin e palës NI & BE INVEST L.L.C. dhe Sigma Construction për hartimin e elaboratit hidrologjik;
- Vendimin dhe Deklaraten e hartuesit të elaboratit hidrologjik nga Sigma Construction Z. Arban Shala ing.dipl.hidro.;
- Licenca A Inxhnier i Licencuar Z. Arban Shala;
- Kushtet Ndërtimore të lëshuara nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Podujevës me nr. 07-350/04-18530/25;
- Çertifikatën e pronës për ngastrën nr. P-71712062-03246-0 të datës 11.02.2025;
- Kopjen e Planit me nr. P-71712062-03246-0 të datës 10.02.2025,
- Kontratat noteriale për krijimin e bashkëpronësisë së re së bashku me ID e pronarëve;
- Planin e situacionit me përpjesë të lexueshme 1:1000 të punuar nga personi i licencuar Z. Ejup Podvorica, ashtu siç kërkohet me UA 03/2018 për procedurat për leje ujore.;
- Licencë Gjeodet nr. 207, ID e Z. Ejup Podvorica.

Pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit tekniko-investiv, shikimit në vend, është vendosur si në dispozitiv.

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së Kontestit Administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr. 5715/25 - ZSP - 2025 Datë, 04.08.2025

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Palës NI & BE INVEST L.L.C.;
2. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
3. ARPL-së;
4. Inspektoriatit të MMPHI-së;
5. Komunës së Podujevës;
6. Arkivit të MMPHI-së.

Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së

Izedin BYTYQI

